



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice**

**Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice**

Nr. 73/2021

Datë: 26/04/2021

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), si dhe në përputhje me nenin 52, nenin 53 (paragrafi 1), nenin 54 dhe nenin 55 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministria e Drejtësisë, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

1. Anulohet Kontrata 0964 e datës 06.11.2020 e nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë z. Selim Selimi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës z. Nehat Thaqi, për dhënien në shfrytëzim të pronës njësie/parcela kadastrale nr. P-70202016-02234-0, zona urbane prej 21217, prona e "Hotel Vicianum" në Vushtrri, pronë e Ministrisë së Drejtësisë, respektivisht Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Obligohet Shërbimi Korrektues i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Me këtë vendim njoftohet edhe Komuna e Vushtrrisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Raporti i auditimit me kërkesë të veçantë me nr. ref. 02/NJAB-2021, i kryer nga Njësia për Auditimin e Brendshëm e Ministrisë së Drejtësisë, ka konstatuar se vendimi nr. 742, dt. 28.05.2019, me të cilin është filluar procedura për dhënien në shfrytëzim të pronës njësie/parcela kadastrale nr. P-70202016-02234-0, zona urbane prej 21217, prona e "Hotel Vicianum" në Vushtrri, pronë e Ministrisë së Drejtësisë, respektivisht Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Raporti i cekur më lartë ka konstatuar se nuk ka bazë ligjore adekuate që përcakton të drejtën e inicimit të procedurës për dhënie në shfrytëzim të pronës në fjalë dhe se kontrata e pasuar nga ky vendim, e lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "ERISI" dhe Ministrisë së Drejtësisë-SHKK-së, nuk përmban bazë ligjore, respektivisht nuk përmban dispozita që rregullojnë dhënie në shfrytëzim të pronës së institucioneve qeveritare.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, Ministria e Drejtësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albulena HAXHIU  
  
Ministre e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Operatorit Ekonomik ERISI - Mitrovicë, përfaqësuesi z. Jahë Osmani;
- Komunës së Vushtrrisë;
- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD
- Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Avokaturës Shtetërore/MD;
- Arkivit të MD-së.